

Data 08.06.2026

**PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MENAXHIMI FINANCIAR, TESTI I ZHVLERËSIMIT DHE IFRS9”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
SHËRBIME TË TJERA -98390000-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,700,000 (Tetë milion e shtatëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor KESH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë: Sa më sipër.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo kërkesë përmbushet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit sipas shtojcës Nr.10.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e fondit të përllogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur, e thjeshtuar - shërbime”, argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e objektit procedurë prokurimi, kërkohet që Operatori Ekonomik ofertues të paraqesë dokumentacionin ku të vërtetojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me Termat e Referencës të kërkuara. Për këtë Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Ligj Nr. 29/2023 PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT (Ndryshuar me aktin normativ nr. 2, datë 7.6.2023; aktin normativ nr. 7, datë 14.12.2023; vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 27.6.2024; aktin normativ nr. 4, datë 27.11.2024, ligjin nr. 9/2025, datë 30.1.2025; nr. 81/2025, datë 11.12.2025) (i përditësuar), VENDIM Nr. 211, datë 9.4.2025 PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 922, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE”, UDHËZIM Nr. 24, datë 6.11.2025 PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E PËRGJITHSHËM NR. 26, DATË 8.9.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR.

Vlera e xhiros së përcaktuar dhe të kërkuar nga autoriteti kontraktor kërkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike të operatorit ekonomik si dhe për të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedurë prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026 minimalisht 3 (tre) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

✚ Drejtuesi i ekipit duhet të jetë kontabilist i certifikuar kombëtar ose ndërkombëtar me eksperiencë në auditimin financiar;

- + Jo më pak se 1 (një) ekspert kontabiliteti të çertifikuar kombëtar ose ndërkombëtar;
- + Jo më pak se 1 (një) ekspert të menaxhimit financiar;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- + Kontratat e punës të vlefshme;
- + CV
- + Çertifikatat/ Dëshmitë e kualifikimit;
- + Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Konkretisht :

Këto kritere janë vendosur në përputhje me termat e referencës, ku është kërkuar zhvillimi i proceseve të vlerësimit që lidhen me analizën financiare dhe zhvlerësimin e aseteve, për të cilat kërkohen ekspertë të specializuar dhe të çertifikuar në fushat përkatëse. Për këtë arsye është përcaktuar kërkesa për një ekip minimal prej 3 (tre) ekspertësh, ku përfshihet drejtuesi i ekipit dhe specialistë të fushave përkatëse, me qëllim garantimin e realizimit cilësor dhe brenda afateve të përcaktuara të shërbimit.

Kërkesa për një grup pune të kualifikuar, me eksperiencë pune dhe në përputhje me kriteret minimale të kërkuara, buron nga rëndësia strategjike dhe kompleksiteti specifik i veprimtarisë së institucionit. Aktiviteti i tij karakterizohet nga një profil unik dhe jo i krahasueshëm me lloje të tjera subjektesh tregtare në vend. Institucioni administron një portofol të konsiderueshëm kredish dhe asetesh me vlerë të lartë monetare, si dhe një volum të madh të aseteve në total, që kërkon një trajtim profesional dhe të specializuar.

Vlerësimi konsiston kryesisht në dy komponentë kryesorë:

-IFRS 9, i cili kërkon ekspertë të trajnuar dhe të përditësuar me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe aplikimin e tyre në sektorin energjetik, me specifikat e një tregu të rregulluar si është në Shqipëri.

-Testi i zhvlerësimit të aseteve, i cili kërkon ekspertë me eksperiencë në kontabilitet dhe analizë financiare, të aftë për të realizuar vlerësimin profesional të aseteve dhe për të analizuar ndikimin e tyre në pasqyrat financiare të institucionit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Sqarim: Kriteret ekonomike dhe teknike të përcaktuara në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, janë vendosur referuar asistencës që Agjencia e Prokurimit Publik (APP), i ka dhënë Autoritetit Kontraktor, në lidhje me procedurën e prokurimit **NR.REF-81645-04-10-2026** me objekt: “Menaxhimi Financiar, Testi i Zhvlerësimit dhe IFRS9” të shpallur në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, i ndryshuar si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Termet e referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojën e Autoritetit Kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

✚ Kryerja e testit të zhvlerësimit (Impairment Test) për Aktivet Afatgjata Materiale, bazuar në aftësinë e tyre për të gjeneruar flukse monetare, për qëllime të Raportimit Financiar, në përputhje me SNRF-të.

✚ Vlerësimi i huave të dhëna edhe të marra me vlerën e drejtë në momentin fillestar për huatë e reja, llogaritja e kostos së tyre të amortizuar si dhe llogaritja e vlerës së drejtë në momentin e paraqitjes në pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

✚ Vlerësim (analizim dhe implementim) për zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) aplikimi i të cilëve hyn në fuqi gjatë periudhës raportuese, që duhet reflektuar gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare si edhe aplikimi i SNRF 9.